



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina

KONTRATA PUBLIKE KORNIZË
616-22-11826-5-2-1/C1308

KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES, (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njëren anë; dhe Muhamet Muçiqi, **LLAPASHTICË E EPËRME, LLAPASHTICE E EPERME**, (ne vazhdim "Kontraktori"), ne anën tjetër, janë pajtuar te lidhin një kontrate publike kornizë për Punët e riparimit/mirëmbajtjes si në vijim:

Rregullimi i varrezave dhe hapesirave ne Komunen e Prishtines

Nr ¹ i prokurimit	616-22-11826-5-2-1
Nr i brendshëm	616 22 178 521

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kësaj kontrate publike kornizë është qe të themeloj kushtet, duke përfshirë çmimet per njësi dhe rregullat e implementimit për kryerjen e punëve të riparimit/mirëmbajtjes në vijim: **Rregullimi i varrezave dhe hapesirave ne Komunen e Prishtines**

1.2 Kontrata publike kornizë do të implementohet me "vendosjen e porosive" apo thirrje. P.sh. Kurdo që Autoriteti Kontraktues apo ndonjë Autoritet tjetër Kontraktues i përfshirë në këtë kontratë, tenton të blejë artikuj në bazë të kësaj kontrate publike kornizë, duhet që të dërgojë "porosinë" tek Kontraktori, duke specifikuar listën e puneve qe duhet te performohen me sasitë e tyre përkatëse.

1.3 Sositë e vlerësuara, të përcaktuara në Pjesën C, Lista e Çmimit, janë vetëm sasi indikative . Autoriteti(et) Kontraktues i përmendur në Nenin 1.1 është (janë) i/të detyruar të përdorë/in këtë marrëveshje kornizë sa herë që të prokurojnë punë, të përmendura në 1.1.

1.4 Kontrata hynë në fuqi me datën e percaktuar ne planin e menaxhimit dhe përfundon në një periudhë prej maksimum 12 muajsh

Neni 2 Koha e përfundimit

2.1 Afati kohor për ekzekutimin e punëve do të jetë 12 muaj nga koha e lëshimit të urdhër blerjes nga ana e Autoritetit Kontraktues.

2.2 Vendi i kryerjes së shërbimeve do të jetë Prishtinë

¹ Të raportohet në çdo dokument apo kërkeshë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit

Neni 3 Çmimi

3.1 Çmimet njësi të punëve riparuese janë paraqitur në Ofertën Financiare, Lista e Çmimit e paraqitur nga Kontraktuesi.

Vlera totale indikative e kontratës është 135,00.00 Euro.

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Kontraktuesit sipas kontratës publike kornizë.

3.3 Çmimet e njësive do të janë fiksë dhe nuk do ti nënshtrohen ndryshimeve për porositë e vendosura nën këtë kontratë publike kornizë..

3.4 Pagesat do të bëhen në përputhje me Kushtet e Përgjithshme dhe/ose të Veqanta të Kontratës.

Neni 4 Rendi i përparësisë së dokumenteve të kontratës

4.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- (a) Kontrata Publike Kornizë;
- (b) Kushtet e Veçanta të Kontratës;
- (c) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
- (d) Tenderi i Kontraktuesit duke përfshirë Specifikimet Teknikë;
- (e) Oferta financiare (Lista e Çmimeve);

4.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.


Neni 5 Komunikimet

5.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Kontraktuesit nga ana tjeter duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të bëhen me shkrim. Komunikatat duhet të dërgohen me postë, mesazh, telefaks, faks, email ose të dorëzohen personalisht.

5.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

5.3 Kudo qe në kontratë parashikohet dhënia e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përvëç nëse specifikohet ndryshe në njoftimin e tillë, pëlqimi, miratimi, certifikata apo vendimi do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njoftoj", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" "do të shenohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendimi i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsy.

5.4 Kjo kontratë është përgatitur në gjuhet Shqipe në tri origjinale, dy origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një original për Kontraktuesin.

Për Autoritetin Kontraktues		Për Kontraktuesin
Visar Shehu	Emri:	ENDRIT
Udhëheqës i Prokurimit	Pozita:	MENAXHER
	Nënshkrimi	
	Data:	13.10.2023
	Vula:	

KUSHTET E PËRGJITHSHME

Neni 1 Përkufizimet

1.1 "Kontratë" do të thotë marrëveshje të lidhur ndërmjet Autoritetit kontraktues dhe Kontraktuesit, siç është shënuar në formularin e kontratës të nënshkruar nga palët, duke përfshirë të gjitha shtojcat për këtë dhe të gjitha dokumentet e inkorporuar me referencë në të.

1.2 "Punë" konsiderohen të gjitha ato punë të cilat janë objekt i kontratës dhe të cilat Autoriteti Kontraktues kërkon që të kryhen nga Kontraktuesi, qofshin ato ndërtim, restaurim, meremetim apo rrënim ndërtesash, pajisje, struktura inxhinieringu civil, struktura të tjera apo pjesë të tyre.

1.3 "Kontraktuesi" është operatori ekonomik (apo grupei i operatorëve ekonomik), i caktuar në formularin e kontratës, i cili (të cilët) është palë në kontratë dhe është i obliguar të kryejë punët sipas marrëveshjes dhe i cili do të marrë shumën sipas marrëveshjes me kontratë.

1.4 "Menaxheri i Projektit" është njeriu i caktuar në kushtet e veçanta të kontratës (apo cilido njeri kompetent i autorizuar nga Autoriteti Kontraktues), i cili është përgjegjës për mbikëqyrjen e kryerjes së punëve dhe për të gjitha hollësitë duhet t'i raportojë Autoritetit Kontraktues.

1.5 "Çmimi Kontratës" do të thotë shuma që i paguhet Kontraktuesit sipas marrëveshjes në formularin e kontratës.

1.6 "Vendi i ndërtimit" do të thotë vendi i caktuar për kryerjen e punëve të kontraktuara.

1.7 "Pajisjet e kontraktuesit" do të thotë e tërë makineria përfshirë edhe atë për bartjen e pajisjeve, dhe mjetet tjera që nevojiten për kryerjen e punëve të kontraktuara që duhet të bëhen sipas kontratës.

1.8 "Skicat" nënkuftojnë vizatimet, llogaritjet, informatat e siguruara dhe të miratuara nga Autoriteti Kontraktues për kryerjen e punëve të kontakuara.

1.9 "KPK" do të thotë Kushtet e Përgjithshme të Kontratës.

1.10 "KVK" do të thotë Kushtet e Veçanta të Kontratës.

Neni 2 Gjuha dhe ligji i aplikueshëm

2.1 KVK e saktësojnë cili është ligji që i përcakton të gjitha çështjet që nuk janë të mbuluara në kontratë.

2.2 Kontrata dhe të gjitha komunikimet e shkruara ndërmjet palëve hartohen në gjuhën e specifikuar në KVK.

Neni 3 Transferimi

3.1 Transferimi do të jetë valid vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes të cilës Kontraktuesi e transferon kontratën e vet ose një pjesë të saj te një palë e tretë.

3.2 Kontraktuesi nuk mundet që, pa miratim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues, ta transferojë kontratën ose një pjesë të saj, ose ndonjë përfitimit apo interes nga ajo, përveç në këto raste:

a) kur ka ngarkesë për pagesë, në favor të bankierëve të Kontraktuesit, të shumave që duhet të paguhen ose që do të bëhen borxh sipas kontratës; ose

b) në rast të dhënies së të drejtës së Kontraktuesit siguruesve të Kontraktuesit për të kërkuar pagesën nga ndonjë person tjetër i detyruar në rastet kur siguruesit e kanë shkarkuar humbjen ose detyrimin e Kontraktuesit.

3.3 Për qëllimet e nenit 3.2, aprovimi i një transferimi nga Autoriteti kontraktues nuk do ta lirojë Kontraktuesin nga obligimet e veta për pjesën e kontratës që tashmë është realizuar ose për pjesën që nuk është bartur.

3.4 Pranuesit e dispozitave të kontratës duhet të plotësojnë kriteret e përshtatshmërisë që zbatohen për dhënien e kontratës përveç në raste kur transferimi bëhet në bankë apo kompani të sigurimit ose institucion tjetër financiar.

Neni 4 Nën-kontraktimi

4.1 Nënkontrata është valide vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes së cilës Kontraktuesi ia beson realizimin e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë.

4.2 Elementet e kontratës që do të nënkontraktohen dhe identiteti i nënkontraktuesve i bëhen të ditura Autoritetit kontraktues me rastin e dorëzimit te ofertës. Ne rast te ndryshimit te nënkontraktuesve gjate implementimit te kontratës, Kontraktuesi duhet te njoftoj me shkrim Autoritetin Kontraktues.. Autoriteti kontraktues do ta lajmërojë Kontraktuesin për vendimin e vet brenda 30 ditë pune nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi. Kontraktuesi nuk nënkontraktion pa autorizim me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Te gjithë nënkontraktuesit e propozuar duhet te përbushin kërkasat e përshtatshmërisë.

4.3 Autoriteti kontraktues nuk njeh lidhje kontraktore ndërmjet vetes dhe nënkontraktuesve, megjithatë mund të siguroj, ku e konsideron si të nevojshme, pagesat direkte për nënkontraktorët.

4.4 Kontraktuesi është përgjegjës për aktet, gabimet dhe neglizhencën e nënkontraktuesve të vet si dhe të agjentëve ose të punësuarve, në të njëjtën mënyrë si po të ishin akte, gabime ose neglizhencë e Kontraktuesit, agjentëve të tij ose punëtorëve të tij. Aprovimi i nënkontraktimit të ndonjë pjese të kontratës ose aprovimi i nënkontraktuesit nga ana e Menaxherit të Projektit nuk e liron Kontraktuesin nga obligimet e tij sipas kontratës

4.5 Nëse nënkontraktuesi ka marrë ndonjë obligim të vazhdueshëm që vazhdon për një periudhë që e tejkalon atë të periudhës së garancisë nën kontratë ndaj Kontraktuesit, përkizati me furnizimet që i jep nënkontraktuesi, Kontraktuesi duhet që, në çfarëdo momenti pas skadimit të periudhës së garancisë, t'i transferojë menjëherë te Autoriteti kontraktues, me kërkasë dhe shpenzime të Autoritetit kontraktues, përfitimet e obligimeve të tilla për kohëzgjatjen e garancisë së skaduar.

Obligimet e Autoritetit Kontraktues

Neni 5 Dhënia e dokumenteve

5.1 Nëse është e nevojshme, brenda 30 ditësh nga nënshkrimi i kontratës, autoriteti kontraktues duhet t'i japë Kontraktuesit, pa pagesë, një kopje të skicave të përgatitura për realizimin e kontratës dhe kopje të specifikimeve dhe dokumenteve tjera të kontratës. Kontraktuesi mund të blejë kopje tjera të këtyre skicave, specifikimeve dhe dokumenteve tjera, në rast se ato janë ne dispozicion. Pas lëshimit të certifikatës përfundimtare, Kontraktuesi duhet ti kthen autoritetit kontraktues të gjitha skicat, specifikimet dhe dokumentet tjera të kontratës.

5.2 Përveç nëse është e nevojshme për qëllime të kontratës, skicat, specifikimet dhe dokumentet tjera që i jep autoriteti kontraktues nuk duhet të përdoren as nuk duhet t'i komunikohen një pale të tretë nga Kontraktuesi pa

pajtim paraprak të autoritetit kontraktues

5.3 Autoriteti kontraktues ka autoritetin për t'i lëshuar Kontraktuesit urdhra administrative që inkorporojnë ato dokumente plotësuese dhe udhëzimet që janë të nevojshme për ekzekutim të mirë të kontratës dhe për kompensim dëmi nga ndonjë defekt të saj.

Neni 6 Qasja në vend punishtë

6.1 Autoriteti kontraktues, në kohë e duhur dhe në përputhje me securinë e punimeve, do ti jap qasje dhe akses Kontraktuesit ne vend punishte, në përputhje me programin e zbatimit të detyrave të përcaktuara në këto Kushte të ngrëjihshme.

6.2 Kontraktuesi, gjate shfrytëzimit, duhet të mirëmbaje çdo objekt të vendosur në dispozicion të tij në gjendje të mirë, dhe duhet, nëse kërkohet nga Autoriteti Kontraktues, ti kthej ato në gjendjen e tyre origjinale pas përfundimit të kontraktit.

6.3 Kontraktuesi nuk do të ketë të drejtë të ndonjë pagese për përmirësimet që rezultojnë nga puna e kryer me iniciativën e tij.

Nenj 7 Ndihma lidhur me nragwala net wew 1

7.1 Kontraktuesi mund të kërkojë ndihmën e Autoritetit kontraktues për marrjen e kopjeve të ligjeve, rregulloreve dhe informatave mbi zakonet, urdhëratë apo ligjet anësore të Republikës se Kosovës të cilat mund të ndikojnë te Kontraktuesi gjatë realizimit të obligimeve të tij me kontratë. Autoriteti kontraktues mund ta jepë ndihmën e kërkuar Kontraktuesit me shpenzime të Kontraktuesit.

7.2 Në bazë të dispozitave të ligjeve dhe rregulloreve mbi punën, Autoriteti Kontraktues do të bëjë të gjitha përpjekjet e nevojshme për të lehtësuar prokurimin nga Kontraktuesi për të gjitha vizat dhe lejet e nevojshme, duke përfshirë lejen e punës dhe lejet e qëndrimit, për personelin, shërbimet e të cilëve Kontraktuesi dhe Autoriteti kontraktues i konsideron të nevojishme si dhe lejet e qëndrimit për familjet e tona.

Obligimet e Kontrolltuesit

Nenj 8 Obligimat e Kortraltura

8.1 Kontraktuesi duhet të veprojë sipas urdhreve administrative që i jep autoriteti kontraktues. Nëse Kontraktuesi konsideron se kërkesa e një urdhri administrativ shkon përtëj fushëveprimit të kontratës, ai, duke iu eksposuar dënimit për shkelje të kontratës, do ta njoftojë autoritetin kontraktues për këtë duke i paraqitur arsyet e tij brenda 30 ditësh pas pranimit të urdhrit. Ekzekutimi i urdhrit administrativ nuk do të nezullohet në shkak të kësaj.

8.2 Kontraktuesi duhet t'i respektojë dhe të veprojë sipas të gjitha ligjeve dhe rregulloreve në fuqi në Republikën e Kosovës dhe do të sigurojë që personeli i tij, të afërmit e tyre, dhe punëtorët vendorë të tij gjithashtu t'i respektojnë dhe të veprojnë sipas këtyre ligjeve dhe rregullave.

8.3 Kontraktuesi duhet t'i trajtojë të gjitha dokumentet dhe informatat e marra lidhur me kontratën si private dhe konfidenciale. Përveç në rastet kur kjo është e nevojshme për qëllime të ekzekutimit të kontratës, ai nuk do të publikoi ose shpalosë asnjë detaj të kontratës.

8.4 Nëse Kontraktuesi është grup, përbërja e grupit nuk do të ndryshohet na përgjimin paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues.

8.5 Kontraktuesi do të siguroj se punët do të fillojnë dhe të përfundojnë brenda afatit të caktuar rënës dokeard -

8.6 Kontraktuesi do të siguroj që të gjitha punët që ai/ajo do të bëjë, si dhe riparimin e defekteve gjatë realizimit të punimeve do të bëhen në kohë dhe në përputhje me standartet, praktikat, metodat dhe procedurat ekzistuese dhe përmes teprer me shkallën e aftësisë dhe zellit, e cila do të pritet nga një kontraktues i aftë që me përvosja që ka ndërtuar.

8.7 Kontraktuesi do të siguroj për cilësinë e punës dhe për cilësinë e materialeve dhe cilësisë profesionale të punonjësve që janë përdorur për realizimin e punës.

8.8 Kontraktuesi duhet tē siguroj zonën e ndërtimit menjëherë pas fillimit të punës pér arsyet e mëposhtme:

- a. në qoftë se pér kryerjen e punëve pajisjet e rënda si: ekskavatorë tē llojeve tē ndryshme, vinça, kamionë tē llojeve tē ndryshme, skela tē larta, etj do tē përdoren; dhe
- b. në mënyrë që tē mos dëmtojë kalimtarët e rastit, objektet përreth, trafikun etj.

8.9 Kontraktuesi do tē jetë përgjegjës pér sigurinë e tē gjitha aktivitetave në vend punim.

Neni 9 Personeli

9.1 Kontraktuesi duhet tē punësoj personel kyç dhe tē përdor pajisje tē identifikuara në tender e tij, pér tē kryer punë ose personel tjetër dhe pajisje tē aprovuara nga menaxheri i projektit. Menaxheri i Projektit do tē aprovoj çdo zëvendësim tē propozuar tē personelit kyç dhe pajisjeve vetëm nëse kualifikimet e tyre përkatëse, ose karakteristikat janë në thelb tē barabarta ose më tē mirë se ato tē propozuara gjatë tenderit.

Neni 10 Siguria e ekzekutimit

10.1 Kontraktuesi do tē, jo më vonë se dita e nënshkrimit tē kontratës, furnizoj Autoritetin Kontraktues me siguri pér ekzekutim tē plotë dhe tē mire tē kontratës. Shuma e sigurisë do tē saktësohet në KVK. Siguria e ekzekutimit do tē ndalet nga pagesa e Autoritetit kontraktues pér çfarëdo humbjeje që është pasojë e mosekzekutimit tē plotë dhe tē duhur tē obligimeve kontraktore nga ana e Kontraktuesit.

10.2 Sigurimi do tē vazhdoj tē mbetet i vlefshëm 30 ditë pas lëshimit të Certifikatës së Pranimit te Përkohshëm.

10.3 Siguria e ekzekutimit tē kontratës do tē jetë në formën e dhënë në pjesën IV tē kontratës.

Neni 11 Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit

11.1 Nga data e fillimit e deri sa tē lëshohet Certifikata e Korrigjimit tē Defekteve, rreziqet e lëndimeve personale, vdekja, dhe humbja ose dëmtimi i pronës (përfshirë, pa kufizim, Punët, Impiantet, Materialet, dhe Pajisjet) janë rreziqet e Kontraktuesit dhe pronës së afërt.

11.2 Kontraktuesi duhet tē siguroj një sigurim nga dita fillimit tē punimeve deri në fund tē periudhës garantuese tē defekteve në shumat e përcaktuara në KVK pér ngjarjet e mëposhtme tē cilat janë pér shkak tē rreziqeve tē Kontraktuesit:

- (a) humbje ose dëmtim i Punëve, Impianeve dhe Materialeve;
- (b) humbje ose dëmtim i Pajisjeve;
- (c) humbje ose dëmtim i pronës (përveç Punëve, Impianeve, Materialeve dhe Pajisjeve) në lidhje me Kontratën; dhe
- (d) dëmtim ose vdekje e personelit te tij.

11.3 Kontraktuesi brenda 15 ditëve pas nënshkrimit tē kontratës duhet t'i dërgoje Autoritetit Kontraktues policën dhe certifikatën pér sigurim që ka pér qëllim kompensimin e nevojshëm pér tē siguruar humbjen apo dëmet e pësuara.

11.4 Në qoftë se kontraktuesi nuk ofron një sigurim tē tillë atëherë kontrata do tē konsiderohet e anuluar dhe kontraktuesi do tē përjashtohet nga pjesëmarrja në aktivitetet e prokurimit pér jo më pak se një vit.

11.5 Në qoftë se ekzistojnë arsyet mjaftueshme dhe bindëse pér zgjatjen e afatit tē ofrimit tē certifikatës mbi sigurim, Autoriteti Kontraktues mund tē zgjasë afatin e caktuar pér dorëzimin e certifikatës mbi sigurimin ose te eliminojë sigurimin dhe tē zbresë çmimin e shpërbllimit nga fitimi i kontraktuesit.

Neni 12 Programi

12.1 Brenda kohës se specifikuar ne KVK, kontraktuesi do t'i dorëzojë Menaxherit të Projektit një program për miratim. Programi do te përbaje se paku me se vijon: mënyrën se si Kontraktuesi propozon ekzekutimin e punëve, asfatin kohor qe kërkon modifikime ne programin e punëve në kuadër të punëve të kontraktuara, kontraktuesi duhet ta rishikojë edhe njëherë programin dhe t'ia kthejë prapë Menaxherit të projektit. Kontraktuesi do të azhurnoj Programin në intervalle jo më shumë se periudha e përcaktuar në KVK.

12.2 Nëse menaxheri i projektit për me tepër kërkon modifikime ne programin e punëve në kuadër të punëve të kontraktuara, kontraktuesi duhet ta rishikojë edhe njëherë programin dhe t'ia kthejë prapë Menaxherit të projektit. Kontraktuesi do të azhurnoj Programin në intervale jo më shumë se periudha e përcaktuar në KVK.

12.3 Për çdo pakënaqësi apo mosmarrëveshje në lidhje me modifikimin e programit, kontraktuesi do të sigurojë argument me shkrim Menaxherit të Projektit.

12.4 Paraqitja e programit të tillë, duke përfshirë çdo shtesë nga menaxheri i projektit nuk do të zgogëloj ose të rris detyrimet e kontraktuesit sipas punëve të kontraktuara, si dhe çdo modifikim të përfshirë në programin e punimeve nuk do të rezultojë në ndonjë pagesë shtesë për kontraktuesin, nëse kjo ka ndodhur si pasojë e negligencës së kontraktuesit gjatë përpilimit të programit.

Neni 13 Siguria në vend-punishte

13.1 Kontraktuesi do të ketë të drejtën të ndaloj qasjen në vend-punishte për çdo person i cili nuk është i përfshirë në zbatimin e kontratës, me përashtim të personave të autorizuar nga Autoriteti Kontraktues.

13.2 Kontraktuesi do të sigurojë sigurinë në vend-punishte gjatë gjithë periudhës së ekzekutimit dhe do të jetë përgjegjës për të marrë hapat e nevojshëm, në interes të punonjësve të tij, agjentëve te Autoritetit Kontraktues dhe palëve të treta, për të parandaluar çdo humbje ose aksident i cili mund të rezultojë nga kryerja e punëve.

13.3 Kontraktuesi do të marrë të gjitha hapat e domosdoshme, për përgjegjësinë e tij dhe me shpenzimet e tij, për të siguruar që strukturat dhe instalimet ekzistuese mbrohen, ruhen dhe mirëmbahen. Ai do të jetë përgjegjës për sigurimin, me shpenzimet e tij, ndriçimin, sigurinë, skermën dhe pajisjet e sigurisë te cilat janë të nevojshme për zbatimin e duhur të detyrave ose që me arsy mund të kerkohen nga Autoriteti Kontraktues

Neni 14 Ndërhyrja me trafikun

14.1 Kontraktuesi do të sigurojë që punimet dhe instalimet nuk shkaktojnë dëme, ose pengojnë trafikun në, lidhjet e komunikimit të tilla si rrugët, hekurudhat, rruge ujore dhe aeroporte. Ai, në veçanti, do të marrë parasysh kufizimet ne peshë kur zgjedh rrugët dhe automjetet.

14.2 Çdo masë te veçantë të cilën Kontraktuesi e konsideron të nevojshme, ose është kërkuar nga Autoriteti Kontraktues me qëllim të mbrojtjes apo për të përforcuar pjesët e rrugëve, urave, do të bartet ne shpenzime të Kontraktuesit, pa marre parasysh se ato kryhen nuk ato kryhen nga Kontraktuesi. Kontraktuesi duhet të njoftojë Autoritetin kontraktues për çfarëdo masa të veçanta që ai synon të ndërmarrë para se kryej ato. Riparimet e dëmit te shkaktuara në rrugë, ura nga transporti i materialeve apo pajisjeve do të jetë në shpenzime të Kontraktuesit.

Neni 15 Tatimi

15.1 Kontraktuesi është përgjegjës për të gjitha tatimet dhe detyrimet doganore në përputhje me Ligjin e Republikës se Kosovës.

15.2 Të gjitha tatimet dhe detyrimet tjera doganore konsiderohet se janë përfshirë në çmimin e kontraktuar.

15.3 Menaxheri i Projektit do të harmonizojë çmimin e kontraktuar nëse konstaton se ka ngritje të tatimeve dhe detyrimeve doganore brenda datës prej 28 ditësh para dorëzimit të tenderit dhe datës së fundit të vërtetimit të përfundimit të punëve.

15.4 Menaxheri i Projektit nuk do të lejojë ndryshimin e çmimit të kontraktuar për shkak të ngritjes së tatimeve dhe/ose ngritjes se detyrimeve doganore në qoftë se kjo ka ndodhur gjatë kohës sa ka qenë në vonesë kontraktuesi.

Neni 16 Kostoja e Riparimeve

16.1 Humbja ose dëmtimi i Punëve ose Materialete që do të përfshihen në Punët në mes të Datës së fillimit dhe në fund të periudhës së Korrigimit të Defekteve do të rregullohet nga Kontraktuesi në koston e Kontraktuesit nëse humbja ose dëmtimi lind nga aktet ose mosveprimet e Kontraktuesit.

FILLIMI DHE VONESAT

Neni 17 Fillimi i punëve

17.1 Kontraktori duhet të fillojë punimet sa më shpejt që është e arsyeshme e mundur pas marrjes së urdhrit me ekspeditën e duhur dhe pa vonesë.

17.2 Kontraktuesi do të ekzekutoj Punët në pajtim me Specifikimet dhe Vizatimet dhe Punët do të kryhen në pajtim me Programin e dorëzuar nga Kontraktuesi, i përditësuar me miratimin e Menaxherit të Projektit, dhe do të plotësoj ato brenda afatit kohor të specifikuar në Nenin 2 të Formularit të Kontratës.

Neni 18 Zgjatja e periudhës së ekzekutimit

18.1 Kontraktuesi mund të kërkojë zgjatje të periudhës së ekzekutimit nëse realizimi i kontratës së tij vonohet, ose pritet se do të vonohet, për ndonjërin nga këto arsyen:

- Autoriteti kontraktues ka dështuar t'i plotësojë obligimet e veta sipas kontratës;
- Forca madhore të përkufizuara si në Nenin 38;

18.2 Brenda 15 ditësh pasi ka kupuar se mund të ketë vonesë, Kontraktuesi duhet ta lajmërojë Autoritetin Kontraktues se ka për qëllim të bëjë kërkesë për zgjatje të periudhës së realizimit për të cilën ai konsideron se ka të drejtë dhe, përvçë nëse ka ndonjë marrëveshje tjetër ndërmjet Kontraktuesit dhe Autoritetit Kontraktues, brenda 30 ditësh i jep Autoritetit Kontraktues të dhëna gjithëpërfshirëse ashtu që të mund të kontrollohet kërkesa.

18.3 Brenda 30 ditësh pas pranimit te detajeve sipas Nenit 18.2 Autoriteti Kontraktues do ti lejojë me shkrim Kontraktuesit këtë zgjatje të periudhës së realizimit nëse mund të arsyetohet, ose në mënyrë prospektive ose retrospektive, ose ta informojë Kontraktuesin që nuk i është dhënë e drejta për zgjatje të periudhës.

Neni 19 Dëmet e likuiduara

19.1 Nëse Furnizues me përgjegjësinë e tij nuk arrin t'i dorëzojë ndonjë ose të gjitha punët brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së punëve të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të porosise. Autoriteti Kontraktues mund të zgresë dëmet e likuiduara nga pagesat te cilat duhet ti behen Konyraktuesit. Pagesat e dëmeve të likuiduara nuk do të prekin detyrimet e kontraktuesit.

19.2 Nëse mosdorëzimi i punëve parandalon përdorimin e zakonshëm të punëve në tërësi, dëmet e likuiduara të parapara në paragrafin 19.1 do të llogariten në bazë të vlerës totale të porosise.

19.3 Nëse Autoriteti kontraktues ka fituar të drejtën të kërkojë së paku 10 % të vlerës së porosise ai mundet, pasi ta njoftojë me shkrim Kontraktuesin:

a. Ne rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar vetem ne emer te vete Autoritetit, me një operatore ekonomik:

- te konfiskojë garancinë e realizimit;
- te ndërpresë kontratën, dhe në këtë rast Kontraktuesi nuk do të ketë të drejtë për kompensim; dhe
- të hyjë në një kontratë me një palë të tretë për dhënien e pjesës së mbetur të punëve. Kontraktuesi nuk do të paguhet për këtë pjesë të kontratës. Kontraktuesi gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij.

b. Ne rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar vetem ne emer te vete Autoritetit, me disa operatore ekonomik:

- te konfiskojë garancinë e realizimit;
- te ndërpresë porosine, dhe në këtë rast Kontraktuesi nuk do të ketë të drejtë për kompensim. Kontraktuesi gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij; dhe
- te ri-hap konkurrencën me pjesën e mbetur të Operatorëve Ekonomik të kontratës publike kornizë.

c. Ne rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar ne emer te disa Autoriteteteve tjera Kontraktuese, me nje operatore ekonomik:

- Autoriteti Kontraktues i cili ka bere porposine anulon porosine dhe ritenderon, dhe në këtë rast Kontraktuesi nuk do të ketë të drejtë për kompensim. Kontraktuesi i gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij; dhe
- te njoftoj Autoritetin Kontraktues i cili ka udhëhequr prokurimin për sjellje të keqe të Operatorit Ekonomik dhe kërkon nga Autoriteti Kontraktues i përmendur qe të konfiskoj një pjesë proporcionale, ekuivalente me 10% te porosise se leshuar, të garancisë së performancës dhe dërgon shumën tek Autoriteti Kontraktues.

a. Ne rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar ne emer te disa Autoriteteteve tjera Kontraktuese, me disa operatore ekonomik:

- te njoftoj Autoritetin Kontraktues i cili ka udhëhequr prokurimin për sjellje të keqe të Operatorit Ekonomik dhe kërkon nga nga Autoriteti Kontraktues i përmendur qe të konfiskoj një pjesë proporcionale, ekuivalente me 10% te porosise se leshuar, të garancisë së performancës dhe dërgon shumën tek Autoriteti Kontraktues;
- te ndërpresë porosine, dhe në këtë rast Kontraktuesi nuk do të ketë të drejtë për kompensim. Kontraktuesi gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij; dhe
- te ri-hap konkurrencën me pjesën e mbetur të Operatorëve Ekonomik të kontratës publike kornizë.

Materialet dhe mjeshtëritë

Neni 20 Regjistri i punës

20.1 Një regjistër i punës do të, përvèç kur parashikohet ndryshe nga KVK, mbahen në vend-punishte nga ana e Kontraktuesit, i cili do të mbaje të paktën informacionin e mëposhtëm:

- kushet e motit, ndërprerjet e punës qe detyrohen nga moti me shi, orët e punës, numrin dhe llojin e punëtorëve të punësuar në vend-punishte, materialet e furnizuara, pajisjet në përdorim, pajisjet jo në gjendje pune, testet e kryera në vend, mostrat e dërguara, rrëthanat e paparashikuara si dhe urdhrat dhëne Kontraktuesit;
- deklaratat e hollësishme të të gjitha elementeve sasiore dhe cilësore të punës së bërë dhe furnizimet e dorëzuara dhe të përdorura, të afta për tu kontrolluar në vend-punishte dhe të rëndësishme në llogaritjen e pagesave qe duhet bere Kontraktuesit.

20.2 Shënimet e bëra në regjistrin e punës, si pune ne progres, duhet të nënshkruhen nga Autoriteti Kontraktues dhe të bashkë-nënshkruhen nga Kontraktuesi ose përfaqësuesi i tij. Nëse Kontraktuesi refuzon, ai do të komunikojë pikëpamjet e tij ndaj Autoritetit Kontraktues në afat prej 15 ditësh pas datës në të cilën janë regjistruar te dhënat apo deklaratat kundërshtuese. Nëse Kontraktuesi dështon qe të nënshkruajë ose të paraqesë pikëpamjet e tij brenda periudhës së lejuar, do të konsiderohet se Kontraktuesi pajtohet me shënimet e paraqitura në regjistër. Kontraktuesi mund të shqyrtojë regjistrin e punës në çdo kohë dhe mund, pa hequr dokumentin, të bëjë ose të marr një kopje të shënimeve të cilat ai i konsideron të nevojshme për informacionin e tij.

20.3 Sipas kërkësës, Kontraktuesi do ta sigurojë Autoritetin Kontraktues me informacionin e duhur për të mbajtur regjistrin e punës në mënyrën e duhur.

Neni 21 Origjina dhe cilësia e punimeve dhe materialeve

21.1 Punët, komponentët dhe materialet do të janë në përputhje me specifikimet, vizatimet, sondazhet, modelet, mostrat, strukturat dhe kërkësat tjera në kontratë dhe do të mbahen në dispozicion të Autoritetit kontraktues për qëllime identifikimi gjatë gjithë periudhës së realizimit.

21.2 Të gjitha pranimet teknike preliminare do të janë objekt i një kërkese të dërguar nga Kontraktuesi tek Autoriteti Kontraktues. Kërkesa duhet ti referohet numrit te kontratës, numrin e Lotit dhe vandin ku do te zhvillohet pranimi i tillë, sipas rastit. Komponentët dhe materialet e specifikuara në kërkësë duhet të certifikohen nga autoriteti kontraktues se plotësojnë kërkësat për këtë pranim para se të inkorporohen në pune.

21.3 Edhe nëse janë pranuar teknikisht materialet apo artikujt që do të përfshihen në pune ose në prodhimin e komponentëve, ato mund të refuzohen dhe duhet të zëvendësohen menjëherë nga Kontraktuesi nëse ndonjë kontrollim tjetër zbulon defekte ose gabime. Kontraktuesit mund t'i jepet mundësia t'i riparojë dhe t'i përmirësojë materialet dhe artikujt që janë refuzuar, por këto materiale dhe artikuj do të pranohen për inkorporim në pune vetëm nëse janë riparuar.

Neni 22 Inspektimi dhe testimi

22.1 Autoriteti Kontraktues do të emëroj "Menaxherin e Projektit", të cekur në KVK, i cili do të jetë përgjegjës për mbikëqyrjen e ekzekutimit të punëve gjatë tërë kohës, duke filluar që nga dita e parë e fillimit të punëve e deri në skadimin e periudhës garantuese të defekteve dhe përaportim tek Autoriteti Kontraktues.

22.2 Qëllimi i mbikëqyrjes është të kontrollojë cilësinë e punëve dhe cilësinë e materialeve të përdorura në pajtim me specifikimet teknike të rëna dakord.

22.3 Kontraktuesi do të sigurojë që komponentët dhe materialet te dorëzohen në kohë në vend për ti lejuar autoritetit kontraktues që të vazhdojë me pranimin e komponentëve dhe materialeve. Kontraktuesi konsiderohet se ka vlerësuar plotësisht vështirësitë që mund t'i hasë në këtë aspekt, dhe nuk do ti lejohet që të paraqesë ndonjë arsyë përvonesë në përbushjen e detyrave.

22.4 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë, ose nga vetë ose agjentit e tij, qe të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshterinë, dhe të kontrollojë progresin e përgatitjes, fabrikimit apo prodhimit të çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për ofrimin e sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshteria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar. Kjo do të bëhet në vendin e prodhimit, fabrikimit, përgatitjes ose në vend-punishte ose në ndonjë vend tjetër, siç mund të specifikohet në kontratë.

22.5 Nëse komponentët dhe materialet i kanë kaluar testet, Autoriteti kontraktues do ta njoftojë Kontraktuesin ose do te miratojë certifikimin e procedurës lidhur me këtë.

22.6 Nëse Autoriteti Kontraktues dhe Kontraktuesi nuk pajtohen për rezultatet e testit, secili do të japë një deklaratë përi pikëpamjet e tij ndaj tjetrit brenda 15 ditëve pas ngritjes se mosmarrëveshjes së tillë. Autoriteti kontraktues ose Kontraktuesi mund të kërkojnë që këto teste të përsëriten në të njëjtat kushte dhe rrethana, ose nëse ndonjëra palë kërkon, nga një ekspert që zgjidhet me pëlqimin e përbashkët. Të gjitha raportet e testimit do t'i dorëzohen autoritetit kontraktues i cili do t'i komunikojë rezultatet e këtyre testeve pa vonesë te Kontraktuesi. Rezultatet e ri-testimit do të janë përfundimtare. Kostoja e ri-testimit do të bartet nga pala pikëpamja e të cilit dëshmohet se është gabim nga ri-testimit.

Neni 23 Paralajmërim i hershëm

23.1 Kontraktuesi pa humbur kohë do të informojë Menaxherin e Projektit, në qoftë se ai/ajo vëren ndonjë gabim apo lëshim në skica (vizatime) apo edhe në specifikime teknike gjatë kryerjes së punëve duke ia tërhequr vërejtjen se ato mund të ndikojnë me vone në kualitetin e punëve.

23.2 Nëse Menaxheri i Projektit vëren ekzistimin e disa gabimeve apo lëshimeve, qofshin ato ne skica apo ne specifikim teknik, ai/ajo do t'i evitoj menjëherë dhe do t'i konsideroj pasojat.

23.3 Nëse palët ne kontrate vlerësojnë se ndërrimet substanciale te punëve janë bere te nevojshme për shkak te gabimeve te tillë ose te përjashtimeve te cilat substancialisht ndikojnë ne çmimin e kontratës, atëherë Menaxheri i Projektit në bashkëpunim me autoritetin kontraktues do te korrigojnë dhe kompensojnë situatën sipas Ligjit te Prokurimin Publik.

PAGESAT

Neni 24 Parimet e përgjithshme të pagesave

24.1 Pagesat do të bëhen në Euro.

24.2 Pagesat do të rregullohen për zbritje për pagesat paradhënie dhe të mbajtjes. Autoriteti Kontraktues duhet të paguaj Kontraktuesit shumë e certifikuar nga Menaxheri i Projektit brenda 30 ditëve nga data e çdo certifikatë. Nëse Autoriteti Kontraktues bën një pagesë me vonesë, Kontraktuesit do ti paguhet interes për pagesë me vonesë në

pagesën e ardhshme. Interesi do të llogaritet nga data në të cilën pagesa duhet të ishte bërë, deri në datën kur pagesa është bërë me vonesë, e rregulluar sipas bankave vendase për kredi në sektorin e ndërtimit.

24.3 Artikujt e Punëve për të cilat nuk është dhënë normë apo çmim nuk do të paguhet nga Autoriteti Kontraktues dhe do të konsiderohen të mbuluara nga normat dhe çmimet tjera në Kontratë.

24.4 Pagesat qe duhet te bëhen sipas faturës se lëshuar nga Kontraktuesi do të bëhen në llogarinë bankare të dhënë në Pjesën V, Identifikimi Financiar, i kësaj kontrate që e plotëson Kontraktuesi. I njëjti formular, që i bashkëngjitet kërkesës për pagesë, duhet të përdoret për t'i raportuar ndryshimet në llogarinë bankare.

24.5 Në rast se Autoriteti kontraktues kryen blerje në emër të autoriteteve të tjera kontraktuese, dhe një autoriteti kontraktues nuk i përbush detyrimet e tij sipas kësaj kontrate, veçanërisht obligimet e Nenit 24.2 kontraktori mund të informojë AQP-ne për shkelje të tillë. AQP-ja mund të ndalojë autoritetin kontraktues nga përdorimi i çdo dhe të gjitha kontratat qendrore publike kornizë të nxjerra nga AQP.

Neni 25 Paramasa dhe Paralogaria

25.1 Paramasa dhe paralogaria duhet të përbajnjë pajisje për ndërtim, instalim, testim, dhe punën e komisioneve qe duhet të kryhet nga ana e Kontraktuesit. Paramasa dhe paralogaria përdoret për të llogaritur çmimin e kontratës. Kontraktuesi do të paguhet për sasinë e punës së kryer në normën e Paramasës dhe Paralogarisë për çdo artikull.

25.2 Në rast të kontratës paushallë, Përshkrimi i Aktivitetit duhet të përbaj aktivitetet me çmim për punët e kryera nga ana e Kontraktuesit. Përshkrimi i Aktivitetit përdoret për monitorim dhe kontroll të kryerjes së aktiviteteve në bazë të të cilave Kontraktuesi do të paguhet. Nëse pagesa për Materiale në vend punim do të bëhet veç e veç, Kontraktuesi do të tregoj shpërndarjen e Materialeve në vend punim veçmas në Përshkrimin e Aktivitetit.

Neni 26 Parapagimi

26.1 Autoriteti Kontraktues do të bëjë pagesë paradhënie Kontraktuesit të shumave të përcaktuara në KVK nga data e caktuar në KVK kundër dispozitës nga Kontraktuesi i një Garancioni të Pakushtëzuar Bankar në një formë të pranueshme për Autoritetin Kontraktues në sasi dhe valutë të barabartë me parapagim. Garancia do të mbetet në fuqi deri sa të bëhet pagesa e parë, por shuma e garancisë duhet të reduktohet në mënyrë progresive nga shuma që paguhet nga Kontraktuesi. Interesi nuk do të paguhet për parapagim.

26.2 Kontraktuesi do të përdorin parapagimin vetëm për të paguar Pajisjet, materialet dhe shpenzimet e tjera të nevojshme posaçërisht për kryerjen e punëve. Kontraktuesi duhet të dëshmoj se pagesa paradhënie është përdorur në këtë mënyrë me furnizim të kopjeve të faturave ose dokumenteve të tjera për Menaxherin e Projektit.

26.3 Parapagim do të paguhet duke zbritur shuma proporcionale nga pagesat përndryshe për shkak të Kontraktuesit, pas orarit të përqindjeve të përfunduar të Punëve në bazë të pagesës.

Neni 27 Mbajtja e Parasë

27.1 Shuma, e specifikuar në KVK, do të ndalet nga çdo pagesë e Kontraktuesit deri në përfundim e tërë të Punëve. Kjo shume ne asnjë rast nuk do te tejkaloj 10% e vlerës totale te kontratës origjinale. Kontraktuesi mund të zëvendësoj paratë e mbajtura me garacion bankar "me kërkesë".

27.2 Shuma e mbajtur ose garancia e mbajtjes do të paguhet brenda 30 ditësh nga dita e lëshimit te deklaratës së llogarisë përfundimtare të referuar në Nenin 29.

Neni 28 Vërtetimet e pagesës

28.1 Kontraktuesi do t'i dorëzojë Menaxherit të projektit raportet mujore të çmimeve të vlerësuara të punëve të përfunduara me minus shumën kumulative të vërtetuar më parë.

28.2 Menaxheri i Projektit do ta kontrollojë punën e kryer të kontraktuesit për të vërtetuar cilësinë e punës dhe vërteton shumën që duhet t'i paguhet kontraktuesit.

28.3 Vlera e punës së kryer do të përcaktohet nga Menaxheri i Projektit.

28.4 Vlera e punës së përfunduar përfshin:

- a. Në rastin e Kontratës së Paramasës dhe Parallogarisë, vlerën e sasisë së punës në Paramasë dhe Parallogari që është përfunduar; ose
- b. Në rast të kontratës paushallë, vlera e punës së ekzekutuar do të përbëj vlerën e aktiviteteve të përfunduara në Përshkrimin e Aktivitetit.

28.5 Vlera e punës së përfunduar përfshin vlerësimin e ndryshimeve dhe shkaqeve për kompensim.

Neni 29 Llogaritja përfundimtare

29.1 Kontraktuesi jo më vonë se 90 ditë pas lëshimit të certifikatës përfundimtare të pranimit, do të dorëzojë tek Menaxheri i Projektit një draft te deklaratës se llogarisë përfundimtare me dokumentet mbështetëse që tregojnë në detaje vlerën e punës së bërë në përputhje me kontratën, së bashku me të gjitha shumat e mëtejshme të cilën Kontraktuesi konsideron se duhet paguar sipas kontratës, në mënyrë që Menaxheri i Projektit të përgatisë deklaratën e llogarisë përfundimtare.

29.2 Brenda 30 ditëve pas pranimit të draft-deklaratës se llogarisë përfundimtare dhe të gjithë informacionit të kërkuar në mënyrë të arsyeshme për verifikimin e saj, Menaxheri i Projektit do të përgatisë deklaratën e llogarisë përfundimtare, e cila përcakton:

- a) Shumen e cila sipas opinionit te tij duhet ti paguhet sipas kontratës; dhe
- b) pas evidentimit te shumave te paguara paraprakisht nga Autoriteti Kontraktues dhe i të gjitha shumave të cilat i takojnë Autoritetit Kontraktues sipas kontratës, bilanci, nëse ka, nga Autoriteti Kontraktues tek Kontraktuesi, ose nga Kontraktuesi tek Autoriteti Kontraktues, siç mund te jete rasti.

29.3 Menaxheri i Projektit do të lëshoje te autoriteti kontraktues ose te përfaqësuesi i tij i autorizuar, dhe te Kontraktuesi, deklaratën e llogarisë përfundimtare që paraqet shumen përfundimtare për të cilën duhet paguar Kontraktuesi në bazë të kontratës. Autoriteti kontraktues ose përfaqësuesi i tij i autorizuar dhe Kontraktuesi duhet të nënshkruajnë deklaratën e llogarisë përfundimtare, si një njohje e vlerës së plotë dhe përfundimtar të punës së realizuar sipas kontratës dhe menjëherë do të dorëzojë një kopje të nënshkruar të Menaxherin e Projektit.

Neni 30 Shkaqet për kompensim

30.1 Shkaqe për kompensim konsiderohen ngjarjet si në vijim:

- (a) Autoriteti Kontraktues nuk lejon qasje në një pjesë të vend ndërtimit data e posedimit e specifikuar në KVK.
- (b) Menaxheri i Projektit urdhëron shtyrje pa dhënë llogari për këtë, ose vonohet apo nuk i jep skicat (vizatimet, specifikacionet) apo udhëzimet e duhura për kryerjen e punëve të kontraktuara në afatin e caktuar si në kontratë.
- (c) Menaxheri i Projektit urdhëron kontraktuesin që t'i zbulojë ose kryejë testet në punën përfundimtare, e cila mandej zbulohet se nuk ka pasur defekt.
- (d) Kontraktuesit tjerë, autoritetet publike, shërbimet komunale ose Autoriteti Kontraktues shkaktojnë vonesë apo shpenzime shtesë për Kontraktuesin.
- (e) Menaxheri i Projektit pa arsyen të justifikuar vonohet në lëshimin e vërtetimit për përbushje të kontratës.

(g) Kontraktuesi has në pengesa tjera për kryerjen e aktiviteteve të punëve të kontraktuara të cilat pengesa nuk janë për shkak të joprofesionalizmit të Kontraktuesit.

30.2 Nëse një ngjarje e tillë ndodh, atëherë Çmimi i Kontratës do të rregullohet po ashtu.

PRANIMI DHE PËRGJEGJËSIA MBI DEFEKTET

Neni 31 Parimet e përgjithshme

31.1 Verifikimi i punëve nga Autoriteti Kontraktues me qëllim të pranimit të përkohshëm ose final do të bëhet në prani të Kontraktuesit. Mungesa e kontraktuesit nuk do të jetë pengesë për verifikimin me kusht që Kontraktuesi te jete informuar prej të paktën 30 ditëve para datës së verifikimit.

Neni 32 Testet përfundimin

32.1 Punët nuk do të pranohen deri sa te jene kryer verifikimet dhe testet e caktuara ne shpenzime të Kontraktuesit. Kontraktuesi duhet të njoftojë Autoritetin Kontraktues për datën në të cilën verifikimi dhe testet të tilla mund të fillojnë.

32.2 Punët te cilat nuk plotësojnë kushtet e kontratës, duhet, nëse kërkohet, të shkatërrohen dhe rindërtohen nga kontraktuesi ose te riparohen, sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktues, përndryshe kjo do të bëhet pas njoftimit të duhur në shpenzime të Kontraktuesit, me urdhër të Autoritetit Kontraktues.

Neni 33 Pranimi i përkohshëm

33.1 Punimet do të merren përsipër nga Autoriteti kontraktues kur të kenë kaluar në mënyrë të kënaqshme testet për pranim dhe te jete lëshuar, ose konsiderohet te jete lëshuar, një certifikatë e pranimit të përkohshëm.

33.2 Kontraktuesi mund të aplikojë, duke njoftuar Autoritetin Kontraktues, për një certifikatë të pranimit të përkohshëm jo më herët se 15 ditë para se punët, sipas mendimit te Kontraktuesit, te jene të gatshme për pranim të përkohshëm. Autoriteti kontraktues brenda 30 ditësh pas pranimit të aplikacionit të Kontraktuesit ose:

- a) t'i lëshojë kontraktuesit certifikatën e pranimit të përkohshëm me një kopje për Autoritetin kontraktues duke thënë, nëse kjo është e përshtatshme, rezervat e tij, dhe përvèç tjerash, edhe datën në të cilën sipas mendimit të tij janë përfunduar punët në pajtim me kontratën dhe janë të gatshme për pranim të përkohshëm; ose
- b) të refuzojë aplikacionin, duke i dhënë arsyet e tij dhe duke specifikuar veprimin të cilin, sipas mendimit të tij i kérkon nga Kontraktuesi për ta lëshuar certifikatën.

33.3 Nëse autoriteti kontraktues nuk arrin ose të lëshojë certifikatën e pranimit të përkohshëm ose të refuzojë furnizimet brenda një periudhe prej 30 ditësh, ai do të konsiderohet se ka lëshuar certifikatën në ditën e fundit të asaj periudhe.

33.4 Pas pranimit të përkohshëm të punëve, Kontraktuesi i çmonton dhe i heq strukturat e përkohshme dhe materialet që nuk kërkohen më për përdorim përkitazi me realizimin e kontratës. Ai gjithashtu do të heqë ndonjë mbeturinë apo pengesë dhe do të bëjë ndonjë ndryshim të gjendjes së vendit të pranimit siç kërkohen në kontratë.

Neni 34 Përgjegjësia mbi Defektet

34.1 Kontraktuesi do të jetë përgjegjës për mënjanimin e defekteve, ose dëmeve, në ndonjë pjesë të punëve të cilat mund të shfaqen apo shfaqen gjatë periudhës se defekteve dhe te cilat lindin nga ose:

- a) përdorimin i impiantit ose materialeve të dëmtuara ose mjeshtëria ose dizajni i gabueshme i Kontraktuesit; dhe / ose
- b) çdo veprim apo mosveprim i Kontraktuesit gjatë periudhës se defekteve.

34.2 Kontraktuesi me shpenzime të veta do ta përmirësojë defektin ose dëmin sa më shpejt të jetë e mundur. Periudha mbi përgjegjësinë e defekteve për të gjitha zëvendësimet ose rïnovimet do te filloj nga data kur zëvendësimi ose rïnovimi është bërë për kënaqësinë e mbikëqyrësit. Nëse kontrata mundëson pranim të pjesshëm, periudha e defekteve do të vazhdohet vetëm për atë pjesë të punimeve e cila është ndikuar nga ndërrimi apo rïnovim.

34.3 Nëse shfaqet ndonjë defekt ose ndodh ndonjë dëm gjatë periudhës së përmendor, autoriteti kontraktues ose menaxheri i projektit do ta njoftojnë Kontraktuesin. Nëse Kontraktuesi nuk arrin të korrigoj një defekt ose një dëm brenda afatit kohor të përcaktuar në njoftim, autoriteti kontraktues mund të:

- të kryejë vetë pune, ose të punësojë dikë tjetër për kryerjen e punimeve, në rrezik dhe kosto te Kontraktuesit, në të cilin rast kostoja e shkaktuar nga autoriteti kontraktues do të zbritet nga pagesat e pritura ose nga garancitë që mbahen ndaj Kontraktuesit ose nga të dy; ose
- të ndërpresë kontratën.

34.4 Në raste urgjente, kur kontraktuesi nuk mund të arrihet menjëherë ose, pasi është arritur, nuk është në gjendje që të marrë masat e nevojshme, autoriteti kontraktues ose Menaxheri i projektit mund të kryejnë punën në kuriz të Kontraktuesit. Autoriteti kontraktues ose Menaxheri i projektit duhet të informojë sa më shpejt që të jetë e mundur Kontraktuesin për veprimin e marrë.

34.5 Periudha e përgjegjësisë se defekteve do të parashihet në KVK dhe specifikimet teknike. Nëse kohëzgjatja e periudhës së përgjegjësisë se defekteve nuk është e specifikuar, ajo do të jetë 365 ditë. Periudha e Përgjegjësisë se defekteve do të fillojë në datën e pranimit të përkohshëm.

Neni 35 Pranimi përfundimtar

35.1 Pas skadimit të periudhës së garancisë ose, në rastet kur ka më tepër se një periudhë, pas skadimit të periudhës së fundit, dhe atëherë kur të janë zgjidhur të gjitha defektet apo dëmet, autoriteti kontraktues do t'i lëshoje Kontraktuesit një certifikatë të pranimit përfundimtar, me një kopje Autoritetit kontraktues, duke cekur datën në të cilën Kontraktuesi i ka plotësuar obligimet e tij sipas kontratës dhe në mënyrë të tillë që autoriteti kontraktues të jetë i kënaqur. Certifikata përfundimtare e pranimit do të lëshohet nga autoriteti kontraktues brenda 30 ditësh nga skadimi i periudhës së garancisë ose menjëherë pasi riparimet eventuale që janë kërkuar sipas Nenit 34 të janë përfunduar në mënyrë të tillë që të jetë i kënaqur autoriteti kontraktues.

35.2 Punët nuk do të konsiderohen se janë realizuar plotësish derisa të jetë nënskruar certifikata përfundimtare e pranimit nga Menaxheri i Projektet dhe te jete dorëzuar tek autoriteti kontraktues, e një kopje tek Kontraktuesi.

35.3 Pa marrë parasysh lëshimin e certifikatës përfundimtare, Kontraktuesi dhe autoriteti kontraktues do të mbeten të detyruar për plotësimin e obligimeve që dalin sipas kontratës para lëshimit të certifikatës përfundimtare të pranimit dhe të cilat kanë mbetur të parealizuara në kohën kur lëshohet certifikata përfundimtare e pranimit. Natyra dhe masa e obligimeve të tillë do të përcaktohen duke iu referuar dispozitave të kontratës.

Shkelja e kontratës dhe shkëputja

Neni 36 Shkelja e kontratës

36.1 Pala ka shkelë kontratën nëse nuk arrin të shlyejë ndonjë nga obligimet e veta me konratë.

36.2 Në rastet kur ndodh një shkelje e kontratës, pala e dëmtuar do të ketë të drejtë për këto kompensime:

- dëmet; dhe/ose
- ndërprerjen e kontratës.

36.3 Përveç masave të sipërpërmendura, mund të jepen dëmshpërblime. Ato mund të janë:

- dëme të përgjithshme; ose
- dëme të likuidueshme.

36.4 Mbulimi i dëmeve, pagesat apo shpenzimet që rezultojnë nga zbatimi i masave të parapara në këtë nen do të zbatohen duke u zbritur nga shumat që duhet t'i paguhen Kontraktuesit, nga depozita, ose me pagesë nga siguria

Neni 37 Shkëputja e kontratës

37.1 Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi mund të shkëpus Kontratën në qoftë se pala tjetër shkakton një shkelje themelore të Kontratës.

37.2 Shkelja themelore e kontratës do të përfshijnë, por nuk do të kufizohet në:

- (a) Kontraktuesi ndërprenë punën për 15 ditë rresht pa qenë e përfshirë kjo ndërprerje në programin e punës si dhe pa autorizim të menaxherit të projektit;
- (b) Menaxheri i projektit urdhëron Kontraktuesin pa arsyet e justifikuar të ndërpresë apo pezullojë aktivitetin e punëve të kontraktuara për më shumë se 15 ditë pune; ose marrëveshjet e arritura mbi pagesat për shkak të kontraktuesit për kosto të vonesës;
- (c) Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi falimenton apo hyn në likuidim tjetër nga rindërtimi ose shkrirja;
- (d) Pagesa e vërtetuar nga Menaxheri i Projektit, nuk paguhet nga Autoriteti Kontraktues brenda 30 ditësh nga data e certifikatës së Menaxherit të Projektit;
- (e) Menaxheri i Projektit njofton se mos korrigimi i defekteve është shkelje e kontratës dhe Kontraktuesi nuk arrin t'i korrigoj brenda 30 ditëve të përcaktuara nga ana e Menaxherit të Projektit;
- (f) Kontraktuesi vonohet në përbushjen e Punëve për numrin e ditëve për të cilat shuma minimale e dëmeve të likuiduara mund të paguhet.

37.3 Kur cilado nga palët kontraktuese njofton Menaxherin e Projektit për shkelje të kontratës për arsyet e tjera nga ato të renditura më lart nën 37.2, Menaxheri i Projektit do të vlerësojë a është shkelja thelbësore apo jo.

37.4 Nëse për shkak të fajit të palës së tretë krijuhen rrethana emergjente objektive dhe kjo e pengon përbushjen e detyrimeve të kontratës, Menaxheri i Projektit me pëlgimin e Kontraktuesit do të përfundoj vazhdimesinë e përbushjes së punëve sa më pare që është e mundur. Menaxheri i Projektit do të bëjë vlerësimin e punës së kryer pjesërisht, do të kërkojë nga kontraktuesi të largohet nga zona e punës dhe ta lënë atë në një gjendje të mirë. Menaxheri i Projektit duhet të paguajë kontraktuesin për punët e kryera deri në momentin e marrjes së njoftimit me shkrim për ndërprerje.

37.5 Në qoftë se kontrata shkëputet, Kontraktuesi do të ndërpres punën menjëherë, do të siguroj vend punimin dhe ta liroj vend punimin brenda 15 ditëve nga përfundimi i periudhës së njoftimit.

Neni 38 Forca madhore

38.1 "Force Madhore" siç përdoret këtu mendohet në çrregullimet industriale, çrregullimet civile, luftërat, eksplodimet, tërmeti, zjarret, vërsimet, epidemitë etj e shkaktuar jo me fajin apo neglizhimin e palëve kontraktuese, e paparashikueshme dhe jashtë kontrollit të palëve kontraktuese.

38.2 Ne rast se ndodh ndonjëra nga ngjarjet që përcakton Forcën Madhore dhe kjo i bën të pamundur punëmarrësit kryerjen e obligimeve dhe përgjegjësive të parapara me kontratë, punëmarrësi sa më shpejtë që është e mundur duhet t'i sigurojë punëdhënësit një deklaratë me shkrim me të dhënat e plota lidhur me ngjarjen. Në këtë rast aplikohen dispozitat si në vijim:

- i. Obligimet dhe përgjegjësitë e kontraktuesit do të pezullohen deri sa të arrihet niveli i mundësisë objektive së përbushjes së tyre.
- ii. Gjatë pezullimit dhe në lidhje me punët e pezulluara, të gjitha shpenzimet lidhur me riparimin e pajisjeve teknike, akomodimit të personelit dhe shpenzimet tjera të ngashme i bart kontraktuesi.
- iii. Brenda pesëmbëdhjetë 15 ditë, duke llogaritë nga dita e ngjarjes që përcakton Forcën Madhore, Menaxheri i Projektit në bashkëpunim me Autoritetin Kontraktues duhet t'i vlerësojë të gjitha punët e përfunduara në mënyrë që Autoriteti Kontraktues ta paguajë kontraktuesin.
- iv. Afati për përbushje të obligimeve nga Kontraktuesi të detyrimeve të kontratës mund të zgjatet edhe për një periudhë për aq sa ka zgjatur periudha e pezullimit.
- v. Në qoftë se kontraktuesi për një kohë të gjatë është bërë i pa aftë, për shkak të Forcës Madhore, për t'i kryer

obligimet dhe përgjegjësitë e parapara me konratë, Autoriteti Kontraktues brenda shtatë 7 ditë mund ta njoftojë me shkrim kontraktuesin për ndërprerjen e konratës.

Neni 39 Pagesa pas shkëputjes së konratës

39.1 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të shkeljes materiale të konratës nga ana e kontraktuesit, Menaxheri Projektues do të lëshoi një çertifikatë mbi vlerën e punës së përfunduar dhe materialet e porositura me më pak se përqindja e cila kërkohet nga vlera e punëve të përfunduara, siç është cekur në KVK. Dëmet shtesë të likuidimit nuk do të aplikohen. Nëse shuma totale e borxhit të Autoritetit Kontraktues tejkalon ndonjë pagesë si borxh ndaj kontraktuesit, diferenca do të jetë obligim borxhi ndaj Autoritetit Kontraktues.

39.2 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të interesit të Autoritetit Kontraktues ose shkeljes materiale bazë të konratës nga Autoriteti Kontraktues, Menaxheri i Projektit do të lëshoj një certifikatë për vlerën e punës së bërë, materialet e porositura, koston e arsyeshme të hecjes së Pajisjeve, riatdhesimin e personelit të Kontraktuesit i punësuar vetëm për Punët, shpenzimet e Kontraktuesit për mbrojtjen dhe sigurimin e Punëve.

Neni 40 Prona

40.1 Të gjitha materialet dhe pajisjet e ndërtimit në vend punim, Impiantet, Punët e Përkohshme, dhe Punët do të konsiderohen të janë pronë e Autoritetit Kontraktues nëse Kontrata ndërpritet për shkak të gabimit të Kontraktuesit.

Neni 41 Lirim i nga Ekzekutimi

41.1 Në qoftë se pamundësohet përbushja e konratës nga shpërthimi i luftës apo ndonjë rasti tjetër jashtë kontrollit të Autoritetit Kontraktues ose Kontraktuesit, Menaxheri I Projektit do të vërtetoj këtë. Kontraktuesi do të siguroj vend punimin dhe do të ndërpres punën sa më shpejt që është e mundur pas pranimit të këtij vërtetimi dhe do të paguhet për punët e kryera para pranimit të tij dhe për punët e kryera më pas për të cilat është arritur marrëveshje.

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Neni 42 Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve

42.1 Palët do t'i bëjnë të gjitha përpjekjet për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, Palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për pozitën e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado Palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkësës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkësës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse Pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkësave për zgjidhje, të dyja palët do të janë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.

42.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përpigen të pajtohen përmes institucionit të specifikuar në KVK. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

Neni 43 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

43.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë:

- ose vendim nga gjyqi;

b) kurdo qe palët pajtohen, vendim arbitrimi në pajtim me KVK.

30.2 Para nënshkrimit te kontratës palët duhet te vendosin për mënyrën e zgjidhjes se mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

KUSHTET E VEÇANTA

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Neni. Nr.	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksi i do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë gjuha Shqipe .
Siguria e ekzekutimit	10.1	Shuma e Sigurisë së Ekzekutimit është: EUR apo 10 % për kohëzgjatjen e periudhës prej 13 muaj.
Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit	11.2	<p>Shuma minimale e sigurimit do të jetë:</p> <ul style="list-style-type: none"> (a) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim lidhur me punët, ndonjë pjesë të tyre, materialet apo impiantin gjatë periudhës mbi të cilën kontraktuesi është përgjegjës për përkujdesjen e tyre, për çfarëdo arsy, përpos rreziqeve të definuara sipas nenit 38 te KPK, kontraktuesi korrigjon humbjen apo dëmtimin e tillë nën shpenzimet e veta, në mënyrë që punët e përhershme në çdo aspekt të jenë në përputhje me dispozitat e kontratës sipas kërkësave të menaxherit te kontratës. Kontraktuesi siguron punët, së bashku me materialin dhe impiantin gjer në koston e zëvendësimit të plotë; (b) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim i Pajisjeve një shumë e cila është e mjaftueshme për zëvendësimin e tyre; (c) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim i pronës (përveç Punëve, Impanteve, Materialeve dhe Pajisjeve) në lidhje me Kontratën shuma minimale është 15.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar. (d) Nëse ndodh ndonjë dëmtim personal ose vdekje: <ul style="list-style-type: none"> (i) e punëtorëve të Kontraktuesit: 50.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar (ii) e personave të tjera: 50.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar
Programi	12.1	Kontraktuesi do ta dorëzoj për aprovim Programin për Punët brenda 15 ditë kalendarike nga data e Nënshkrimit të kontratës.
	12.2	Periudha për Programin e azhurnuar është 15 ditë kalendarike nga data e

		pranimit te kérkesës se Menaxherit te projektit.
Fillimi i punëve	17.1	Data e fillimit do të jetë 3 dite pas nënshkrimit të planit të menaxhimit.
	17.2	Data e përfundimit e të gjitha Punëve do të jetë 12 muaj.
Regjistri i punës	20.1	Një regjistër i punës do të mbahen në vend-punishte nga ana e Kontraktuesit].
Inspektimi dhe testimi	22.1	Menaxheri i Projektit është: do te përcaktohet pas nënshkrimit te kontratës
Parimet përgjithshme pagesave e të	24	<p>Pagesat do te behën ne situacione.</p> <p>Situacionete paguhen ne vleren prej 30 000,00€ , e me teper me konstatim nga menaxheri i kontrates dhe organi mbikqyres .</p>
Parapagimi	26.1	Shuma e Parapagimit është: nuk ka pagese paraprake
Mbajtja e Parasë	27.1	<p>Shuma e parave të mbajtura është: 10% i vlerës se kontratës.</p> <p>Kjo shume do të ndalet nga çdo pagesë e Kontraktuesit dhe do të paguhet brenda 30 ditësh nga dita e lëshimit te deklaratës së llogarisë përfundimtare të referuar në Nenin 29 te KPK.</p> <p>Kontraktuesi mund të zëvendësoj paratë e mbajtura me garacion bankar "me kérkesë".</p> <p>Shuma e parave te mbajtura do te mbahet gjate tere periudhës se defekteve (3 vite)</p>
Shkaqet përkompensim	30.1	Data e posedimit të vend punimit do të jetë 3 ditë pas nënshkrimit të planite te menaxhimit
Rezervat		10 ditë pas nënshkrimit të kontratës OE duhet të ketë çdoherë rezerva për të gjitha produktet e kontratës në stoqe.
Përgjegjësia mbi Defektit	34.5	Periudha garantuese e defekteve është 3 vite.
Pagesa shkëputjes pas së kontratës	39.1	Përqindja që do të zbatohet për vlerën e punëve që nuk janë përfunduar, që përfaqëson koston shësë të Autoritetit Kontraktuesin për kompletimin e Punëve, është përqindja e vlerësuar të punëve të pakryera minus shuma e dëmeve te likuiduara.
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve	42.2	Komisioni për Ndërmjetësim ne kuadër te Ministrisë se Drejtësisë
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore	43.1	<p>a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet Gjykatën Themelore-Prishtinë në pajtim me ligjin në Kosovë.</p> <p>ose</p> <p>b) kurdo qe palët pajtohen, çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në arbitrazh të Tribunali i Përherdhëm i Arbitrazhit të Kosovës në kuadër të Odës Ekonomike të</p>

Kosovës, në përputhje me rregullat e Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë.

Para nënshkrimit te kontratës palët duhet te vendosin për mënyrën e zgjidhjes se mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

RRETHOJA PËR VARREZA - KONTRATË KORNIZË

Nr.	PERSHKIMI I PUNËVE	Njësie	Sasi	Qmimi me TVSH	Shuma me TVSH
	Piketimi i pukeve në të cilat do të vendoset rretheja. Vërtetje: 1. Ky position jo domosdoshmërisht do të realizohet në të gjithë lokacionet per vërm në lokacionet të cilat shqiptar menaxhues i kontraktës specifikisht kërkon. 2. Plikimi duhet të realizohet përmes gjedhjes së licencave që me koordinata të saktë.	copë	1	29	39.00 €
1	Demonstrimi largim i rrethejeve shkallëzuese dhe themelore të shkallëve të rrethejeve. Në përzicën të përfshihet edhe transporti dhe depozimi i tyre në lokacionin e përcaktuar nga Autoriteti Kontraktues. Vërtetje: 1.Ky position jo domosdoshmërisht do të gjithë lokacionet per vërm në lokacionet të cilat shqiptar menaxhues i kontraktës specifikisht kërkon. Punjimi me materialin, punimi dhe montimi i rrethejës si se është jet e hashqiangjitur. Rretheja përbëhet nga: -Shkallë me dimensione të përgjithshme 80x80x3.5mm me gjatësi 1.8-2.2m (për 2.16m); -Hemjet e gjerë 25/30 mm dimensione 60x60x3.5mm si ndotje për rrethejën (për 2.16m); -Paneli i përbërë nga dy shtrave horizontale me dimensione të përgjithshme 60x60x2.0mm me gjatësi 2.0m dhe 16 shtrave vertikale me dimensione të përgjithshme 20x20x2.0mm me gjatësi 1.4m ; -Plakat për ankerin 250x250x1.5mm si bazuha me anker si n'dojet e hashqiangjitura (për 2.16m); Para dhe gjatë ekzistencës së punimeve në pozicion duhet të parashitet më: -Gjerrimi i shkatërrave për shkallëzimet e themelit 60x60x3.5mm; -Pastrimi fitorenitari i shpërndajse përmes vijës ku parashitet të vendoset rretheja (min 2m gjerrji), ngarkimi i mbeturinave të krijuara, mbeturinave ndërtimore dhe ataz nga gjërmimi, transportimi dhe depozimi i tyre në depozitë të komunave. Vërfjetje: -Në lokacionet kur përfshihet e terrenit shëtit 23° rretheja ekzistuese me kaskada shumë rrejtje shtesë. Në lokacionet kur përfshihet e terrenit shëtit 23° është 615° rretheja ekzistuese me kaskada do të rritur gjendjen e shtruve vertikale dhe kufirës horizontale të poshtme të panelit të rrethejës si edhe marrë këndin e terrenit. Në lokacionet kur përfshihet e terrenit shëtit 23° rretheja duhet të punohet në formë të paralelogramit duke ruajtur këndin e shtruve vertikale derisa shfuzzat horizontale marrin këndin e terrenit. -Plakat e ngarkonte duhet të vendoset në beton tif një deri deri shtruje duhet të salidhet si qendër me gjatësi 18 rrethejës; -Shkallët e ankrave duhet të vendoset në beton tif një deri deri shtruje duhet të salidhet si qendër me gjatësi parametrit; -Të gjitha salidmet duhet të realizohen me C02 siç standardizohet të paraparë përmes kësaj soldimit; -Të gjitha salidmet duhet të realizohen në tri shtrresa (parangjyrdhës) ose dy shtrresa ngjyrës; -Ngjyra duhet të realizohet në tri shtrresa (parangjyrdhës) ose dy shtrresa ngjyrës; -Ngjyra përcaktohet nga Organet mbiqësive; -Për shkak të formës së përcakta rruji i shkallëve, themelore, ankrave dhe pikave ankaruese mund të rritet, pasqyri në çdo shtruje duhet të parashitet një shkallë. Në këtë rast duhet të rritet distanca ndëm 18 shtruve vertikale të panelit; -Qmimi duhet të jetet përmes një metri gjatësi të rrethejeve.	m ²	1	1.5	1.50 €
2	Funkcioni me materialin, punimi dhe montimi i dyshme hyrëse për këmbësorë (gjerësia totale 1.3m). Dyert duhet të jenë me dizajn të njëjtë si rretheja (lormiza me profile 40x40x3mm dhe shtrufat mbushëse 20x20x2mm me distancë 16 njëjësi si një rrethejë). Në pozicion të parashitet edhe montimi i tyre. Gjithashtu para montimit të dyerave duhet të realizohet edhe pastrimi fitorenitari i shpërndajse përmes vijës ku parashitet të vendoset dyer (min 2m gjerrji), ngarkimi i mbeturinave të krijuara, mbeturinave ndërtimore dhe ataz nga gjërmimi, transportimi dhe depozimi i tyre në depozitë të komunave. Vërfjetje: Të gjitha salidmet duhet të realizohen me C02 siç standardizohet të paraparë përmes kësaj soldimit; -Të gjitha salidmet dhe përpunimi shpërndajse i tyre duhet të bëhet para hyrjes; -Lyerja duhet të realizohet në tri shtrresa (parangjyrdhës) ose dy shtrresa ngjyrës; -Ngjyra përcaktohet nga Organet mbiqësive;	m ²	1	100	100.00 €
3	Funkcioni me materialin, punimi dhe montimi i dyshme hyrëse për këmbësorë (gjerësia totale 1.3m). Dyert duhet të jenë me dizajn të njëjtë si rretheja (lormiza me profile 40x40x3mm dhe shtrufat mbushëse 20x20x2mm me distancë 16 njëjësi si një rrethejë). Në pozicion të parashitet edhe montimi i tyre. Gjithashtu para montimit të dyerave duhet të realizohet edhe pastrimi fitorenitari i shpërndajse përmes vijës ku parashitet të vendoset dyer (min 2m gjerrji), ngarkimi i mbeturinave të krijuara, mbeturinave ndërtimore dhe ataz nga gjërmimi, transportimi dhe depozimi i tyre në depozitë të komunave. Vërfjetje: Të gjitha salidmet duhet të realizohen me C02 siç standardizohet të paraparë përmes kësaj soldimit; -Të gjitha salidmet dhe përpunimi shpërndajse i tyre duhet të bëhet para hyrjes; -Lyerja duhet të realizohet në tri shtrresa (parangjyrdhës) ose dy shtrresa ngjyrës; -Ngjyra përcaktohet nga Organet mbiqësive;	m ²	1	80	80.00 €
4	Funkcioni me materialin, punimi dhe montimi i dyshme hyrëse për autonjete të përbërë nga shi pjesë (gjerësia totale 5m). Dyert duhet të jenë me dizajn të njëjtë si rretheja (lormiza me profile 40x40x3mm dhe shtrufat mbushëse 20x20x2mm me distancë 16 njëjësi si një rrethejë). Vërfjetje: -Të gjitha salidmet duhet të realizohen me C02 siç standardizohet të paraparë përmes kësaj soldimit; -Të gjitha salidmet dhe përpunimi shpërndajse i tyre duhet të bëhet para hyrjes; -Lyerja duhet të realizohet në tri shtrresa (parangjyrdhës) ose dy shtrresa ngjyrës; -Ngjyra përcaktohet nga Organet mbiqësive;	copë	1	250	250.00 €
5	Totali i 1.00.50 €				
					Artikoli i 1.05 % e poshtës për vlerësimin

REAKTJULLIM	Cantim total	Cantim total i peshuar
A - Gjithsej (1-3): 85%	€ 140.50	€ 119.41
B - Gjithsej (4-5): 15%	€ 38.00	€ 48.50

(Nmimi i Përgjithshëm i peshuar (ofertat do të vlerësohen ne bazë të kësaj viere). Kjo është vlera e cila da të duhet të shenohet në Formularin e ofertës që do të levohet gjatë hapjes publike.

€ 168.93